



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

---

## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

### SESIONI II (I DETYRUAR)

### SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

### VARIANTI A

#### Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

#### Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja – seksioni dygjuhësh

#### *Udhëzime të përgjithshme:*

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Pasaktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuara gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

**PJESA I****Ismail Kadare****Në studion dimërore**

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	C	1 pikë

**Pyetja 7**                      **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Dimri është përcaktues i gjendjes shpirtërore që po kalon heroi lirik. Ai hyn kudo me ftohtësinë e tij, mes sendeve, librave, në marrëdhëniet njerëzore dhe në shpirtin e poetit.
- Ky përdorim është metaforik. Kadare e shfrytëzon si një detaj për të përcaktuar situata që përngjasojnë me dimrin, acarin.
- Kadare e përdor edhe për të zbuluar edhe vetë gjendjen shpirtërore të poetit.

**1 pikë**                      Nëse tregon cili është roli i dimrit në poezi.

**1 pikë**                      Nëse shpjegon përdorimin e tij.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

**Pyetja 8**                      **2 pikë****Model përgjigjeje**

- U trandën- u drodhën, u tundën.
- Funkzioni: *folja trandën*, e marrë nga gegërishtja, krijon përshtypjen e diçkaje të fortë që po ndodh, mbart një peshë (zanorja *a* dhe rrokja e mbyllur në fund –*ën*) dhe ngarkesë emocionale shumë më të madhe. Përdorimi i saj e shton dramacitetin e asaj që pritet të ndodhë.

**1 pikë**                      Nëse gjen sinonimin e foljes trandën.

**1 pikë**                      Nëse shpjegon funksionin e këtij përdorimi.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 9**                      **2 pikë****Model përgjigjeje****Detaje ose shprehje:**

*Si nga qendra e dimrit ti erdhe drejt, shndërroheshin në dënësë, për të ngrirë sërish, në frizerin kujtesë.*

**2 pikë**                      Nëse gjen dy detaje që japin thelbin e marrëdhënieve midis vajzës dhe poetit.

**1 pikë**                      Nëse gjen vetëm një detaj.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 10**                      **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Ndoshta fajtores mund të jetë vajza, pasi ajo e sjell ftohtësinë në studion e poetit me flokët e saj gjysmë të ngrirë.
- Vetë poeti duket sa ka energji pozitive. Por jo vajza, e cila e sjell këtë ftohtësi me vete, nga jashtë. Flokët e saj shkrijnë në studion e poetit.
- Vargjet ku shfaqet kjo:

Kokrrizat e breshrit  
Shkrinin pikë-pikë.  
Dhe  
Për të ngrirë sërish  
Në frizerin kujtesë

- Marrëdhënia që krijohet është kundërshtie.

**1 pikë**                      Nëse tregon se kush e sjell ftohtësinë në studio.

**1 pikë**                      Nëse tregon vargjet ku shfaqet kjo.

**1 pikë**                      Nëse tregon raportin që krijohet midis tyre.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 11**                      **2 pikë**

**1 pikë**                      Nëse gjen një metaforë të shprehur me emër: *frizerin kujtesë, perlë, muzikë, kryq, vdekja, zonja, etj.*

**1 pikë**                      Nëse gjen një metaforë të shprehur me folje: fjalët **ngrijnë**, dritaret **u trandën**.

**Pyetja 12**                      **4 pikë**

**2 pikë**                      Vajza konvertohet në diçka shpirtërore shprehur në një varg krahasimesh: në muzikë, në pikëllim, në kryq.

**Si muzikë:** ajo mbeti për poetin frymëzuese, e ndjeshme, e bukur, prekëse...

**Si pikëllim:** gati si vdekje, ndarja ishte e dhimbshme.

**Si kryq:** e mundimshme.

**2 pikë**                      Duke u ndalur në krahasimin e zgjeruar: guaska – veshja e jashtme, perla është thesari i fshehur brenda saj. Dhe poetit i intereson ajo, perla dhe jo ana e jashtme. Ai e çmon vajzën si të tillë, pavarësisht nga mosmarrëveshjet.

**OSE**

Në mënyrë metaforike poeti do ta marrë nga guaska perlën, dashurinë e bukur, të çmuar, të vlefshme, të fshehur, të heshtur.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**PJESA II****Flober****Zonja Bovari**

Pyetja 13	C	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	D	1 pikë
Pyetja 16	B	1 pikë
Pyetja 17	C	1 pikë
Pyetja 18	A	1 pikë
Pyetja 19	B	1 pikë

**Pyetja 20 (a) 2 pikë****Model përgjigjeje**

- Sharli lumturohet, gëzohet pamasë.
- *...ngrihej, e puthte, i ledhatonte fytyrën me duar, e thërriste mamakë, e ftonte të vallëzonte, dhe, nxirrte nga goja, gjysme me të qeshur, gjysmë me të qarë, gjithfarë shakash përkëdhelëse që i vinin në mend, etj.*

**1 pikë** Nëse tregon cila është ndjenja që përjeton Sharli.

**1 pikë** Nëse identifikon një moment që ilustron raportin që ai ka me Emën.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 20 (b) 2 pikë****Model përgjigjeje**

- Sharli mendon se tani nuk i mungon më asgjë.
- Sharli është i lumtur dhe mendon se i ka të gjitha: ka punën, një grua që e adhuron dhe në fund fëmijën që plotëson tablonë e një jete të lumtur familjare.

**1 pikë** Nëse tregon se ç' mendon Sharli në lidhje me jetën që ka.

**1 pikë** Nëse tregon arsyen pse Sharli mendon kështu.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 21 3 pikë**

**1 pikë** Në fillim Emës i vjen çudi, habitet.

**1 pikë** Më pas nuk ka asnjë lloj entuziazmi, as dëshire.

**1 pikë** Në fund fillon të ketë interes, kërkon të ketë një djalë.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 22**                    **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Vajzat është delikate, e varur nga të tjerët, peng i rregullave dhe normave.
- Djali është i lirë, mund të bëjë gjithçka dhe t'i plotësojë vetes gjithçka.
- Ajo kërkon të lindë djalë dhe për të përmbushur dëshirat e saj romantike.

**2 pikë**                    Nëse gjen dy arsye pse Ema nuk dëshiron të lindë vajzë.

**1 pikë**                    Nëse gjen vetëm një arsye.

**0 pikë**                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 23**                    **2 pikë**

- Në momentin që e kupton se nuk mund t'i blejë dot veshje të shtrenjta, të qëndisura, me perde mëndafshi, asaj i zbehet dashuria për fëmijën. Çdo gjë Ema e projektton mbi ndjesitë e saj romantike, edhe ndjenjën për fëmijën. Janë ato që e udhëheqin. E beson shumë paraqitjen e jashtme. I zbehet dashuria për fëmijën, në momentin që kupton se nuk mund të plotësojë dëshirat romantike që ka për veshjen e foshnjës. *Nuk u argëtua pra, me këto parapërgatitje që shtojnë dhembshurinë e nënave dhe qysh në fillim, dashurinë për foshnjën sikur ia zbehu diçka.*

**2 pikë**                    Nëse shpjegon në mënyrë të plotë ndikimin që kanë të Ema idetë e saj romantike edhe në momentin që do të bëhet me fëmijë. Mendimin e ilustron me shembuj nga fragmenti.

**OSE**

**1 pikë**                    Nëse shpjegon në mënyrë të pjesshme ndikimin që kanë të Ema idetë e saj romantike edhe në momentin që do të bëhet me fëmijë. Përdor ndonjë ilustrim ose jo nga fragmenti.

**0 pikë**                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 24**                    **3 pikë**

**1 pikë**                    Ema kthen kokën mënjanë dhe i bie të fikët.

**1 pikë**                    Jo ajo nuk është e lumtur. Mendoj se duhet të jetë e zhgënjyer dhe e hidhëruar, siç është për çdo gjë që e rrethon.

**1 pikë**                    Duke lexuar me kujdes paragrafët para se ajo të lindë, ne dimë se ç'mendon Ema për vajzat. Fakti se ajo kthen kokën mënjanë dhe i të fikët kur mëson se ka lindur vajzë, na bën të mendojmë se ajo s'është aspak e lumtur.

**0 pikë**                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 25**                      **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË**                      **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton nëse e krijon vetë Ema burgun e saj.
- shpjegon pse mendon në këtë mënyrë.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga fragmenti ose vepra.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

**KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË**                      **2 pikë****1 pikë**                      **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
  - hyrjen
  - zhvillimin
  - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

**1 pikë**                      **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

**KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI**                      **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**                      **2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.